

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEÇE KAI

GSK-KPA-A-057/2013

Prishtinë,
21 tetor 2013

Në çështjen juridike të:

I.U

Pala ankuese/Pala përgjegjëse në kërkesë

kundër

B.M

Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit të EULEX-it, Willem Brouwer dhe Sylejman Nuredini, gjyqtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/127/2011 (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA15129), të datës 21 tetor 2011, pas shqyrtimit të mbajtur më xxx, mori këtë

AKTGJYKIM:

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa;
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore KPCC/D/A/127/2011, i datës 26 tetor 2011, për sa i përket lëndës së regjistruar me numrin KPA15129;

3. Obligohet I.U që t'i paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 130 euro (njëqind e tridhjetë euro) në buxhetin e Kosovës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

1. Çështjet procedurale

- 1.1. Më 5 shtator 2016, B.M ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar konfirmimin e së drejtës së saj pronësore në 1/15 e ngastrës kadastrale 885, me sipërfaqe prej 0 90 07 ha (këtej e tutje: ngastra) sipas fletës poseduese 171 të komunës kadastrale të Babimocit.
- 1.2. KKPK-ja ke gjetur se kërkesa ishte a bazuar dhe i ka pranuar Palës përgjegjëse në ankesë të drejtën e saj pronësore.
- 1.3. Ngastra është në shfrytëzim të I.U.
- 1.4. Vendimi i është dorëzuar I.U më 11 shkurt 2013.
- 1.5. I.U ka paraqitur anekse kundër vendimit të KKPK-së më 11 shkurt 2013.
- 1.6. Versioni (i përkthyer) i ankesës i është dorëzuar B.M, e cila nuk ka paraqitur ndonjë përgjigje në ankesë.

2. Çështjet faktike

Gjykata Supreme i merr si fakte çështjet e mëposhtme, të cilat janë vërtetuar nga KKPK-ja dhe nuk janë kundërshtuar nga palët ose përndryshe nuk janë dëshmuar si të gabueshme:

- 2.1. Vendimi mbi trashëgiminë i Gjykatës Komunale në Prishtinë T.nr. 14/96, i datës 14 shkurt 1996, me të cilin është vendosur pasuria e M.M. M.M është bashkëshorti i ndjerë i B.M.
- 2.2. Në vendimin e lartpërmendur mbi trashëgiminë është vërtetuar se prona përfshinte të drejtën pronësore ndaj 1/5 së ngastrës. Për më tepër, B.M do të trashëgonte 2/3 e pjesës së kësaj ngastre ndërsa i biri i saj, N.M, do të trashëgonte 1/3 e pjesës së kësaj ngastre, gjë që e bënte B.M pronare të 2/15, dhe të birin e saj bashkëpronar të 1/15 të ngastrës.
- 2.3. Vendimi mbi trashëgiminë i referohet pjesërisht fletës poseduese të zonës kadastrale të Babimocit, nr. 72602001, në të cilën 2/15 e ngastrës i atribuohet B.M. Përveç B.M dhe të birit të saj, edhe personat në vijim janë përmendur në listë si bashkëpronarë të ngastrës: A.M, D.M, M.M dhe M.M.2.

2.4. I.U kërkon konfirmimin e së drejtë së tij pronësore ndaj pronës pasi që posedimi dhe shfrytëzimi i saj i janë dhënë B.M.

3. Arsyetim ligjor:

Juridiksioni

3.1. Sipas nenit 3.1 të Rregullores nr. 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, Agjencia Kosovare e Pronës ka kompetencë që të pranojë dhe regjistrojë dhe, nëpërmjet Komisionit për Kërkesa Pronësore, të zgjidh, varësisht nga e drejta në ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, kërkesat pronësore lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale si dhe kërkesat që përfshijnë të drejtat e shfrytëzimit lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale që bien në kategoritë që kanë të bëjnë me konfliktin ku përfshihen rrethanat që drejtpërsëdrejti apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

3.2. Në kërkesën e saj B.M ka deklaruar se asaj i është dashur ta braktisë ngastrën për shkak të rrethanave që ndërlidhën drejtpërsëdrejti ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Deklarata e B.M nuk ishte kontestuar në shkallën e parë dhe as në shkallën e ankesës dhe lënda nuk jepë kurfarë të dhëne se kjo deklaratë do të ishte falso. Prandaj, Gjykata gjen se lënda është në juridiksionin e Gjykatës.

Pranueshmëria

3.3. Vendim i ishte dorëzuar I.U më 11 shkurt 2013. I.U ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së më 11 shkurt 2013, që është brenda afatit prej 30 ditëve të paraparë me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale.

3.4. Prandaj, ankesa e I.U është e pranueshme.

Meritat

3.5. Në ankesën e tij I.U e konteston vendimin e KKPK-së mbi pronësinë legjitime të ngastrës së B.M. Pasi që I.U deklaron se ai është pronar legjitim i ngastrës, ai duhet ta dëshmojë këtë deklaratë.

I.U deklaron se e kishte blerë ngastrën para 29 viteve nga bashkëshorti i B.M, M.M, dhe se ky i fundit dhe B.M e kishin pranuar pagesën.

3.6. Si provë I.U ka paraqitur “raportin e ekspertit gjeodet” (këtej e tutje: raporti i gjeodezisë) të datës 08 mars 2010 nga A.A, ekspert i Gjeodezisë, i caktuar nga Gjykata Komunale e Prishtinës (aktvendimi: C.no.425/09). Verifikimi sipas të gjitha gjasave ishte iniciuar nga B.M2 dhe kundër-iniciuar nga D.M dhe M.M2 nga B. Ky verifikim sipas përmbajtjes së tij është dashur që të përcaktojë një pjesë të ngastrës kadastrale numër 885 si pronë të B.M2.

3.7. Rapordi i gjeodezisë cek si në vijim:

(...)”ngastra kadastrale nr. 885, plani dhe skica 5/13 në vendin e quajtur “ndërmjet rrugëve” me kulturë arë e klasës 2, me sipërfaqe prej $S=0.90.07ha$, pronë private sipas certifikatës të së drejtës mbi pronën e paluajtshme nr. 171 e regjistruar në bashkëpronësi dhe atë 3/16 M.A; 2/5 M.B (P.); 3/15 M.D; 3/15 M.M3; 3/15 M.M4 dhe 1/15 M.N (M.) nga P.. (...)Prona e paluajtshme (...) si pjesë e ngastrës 885 (...) të cilën parashtruesi e kishte në shfrytëzim kufizojë nga këta pronarë (...)

3.8. Pika 3.7 e raportit të cituar të gjeodezisë nuk mund të konsiderohet si dëshmi se I.U e ka drejtën pronësore ndaj ngastrës. Ajo thjeshtë përcakton pronën e B.M duke nënvizuar kufizimin e saj. Dhe ngastra përshkruhet si pjesë e kufirit të pronës së B.M. Në fakt, raporti i gjeodezisë vërteton se 2/15 e ngastrës është në pronësi të B.M.

3.9. Për më tepër, kur përmendet pjesa e ngastrës 885 së I.U raporti i gjeodezisë thekson: *“në lindje nga pika 7 deri te pika 27 me një gjatësi prej 25.94 kufizohet me pjesët e ngastrës kadastrale nr. 885 e cila është në shfrytëzim të I.U” (...)* Ndërsa pjesa tjetër e ngastrës kadastrale nr. 885 (...) me sipërfaqe prej $S=0.60.07ha$ të cilën e ka pasur në shfrytëzim I.U kufizohet me këta pronarë dhe ngastra kadastrale sipas gjendjes kadastrale dhe faktike është si në vijim(...).”

3.10. Citimi cek se një pjesë e ngastrës që shfrytëzohet nga I.U ka kufizohet me pjesën e përmendur në pikën 3.7. Në fakt ai vërteton se ngastra është në pronësi të B.M ndërsa të tjerat të familjes M..

3.11. Prandaj, gjykata nxjerr përfundim se raporti i gjeodezisë si i tillë nuk jep ndonjë provë çfarëdo qoftë ajo se I.U është pronar legjitim i 2/15 pjesë të ngastrës 885 në fjalë.

3.12. Si provë tjetër I.U e ka paraqitur edhe deklaratën e M.M2, vëllait të M., ku thuhet se I.U e kishte blerë ngastrën 855 para 30 viteve.

3.13. Gjykata e konsideron këtë deklaratë të vetme si të pamjaftueshme për të dëshmuar se I.U e ka blerë pronën. Gjykata merr parasysh se deklarata nuk mbështetet me ndonjë dëshmi të shkruar. Nuk ekziston kontrata, e as nuk është bërë regjistrimi në regjistrin publik i cili jep dëshmi për një blerje të tillë. I.U pa dyshim deklaron se B.M nuk po e thotë të vërtetën dhe se duhet të ketë një kontratë mbi shitblerjen e supozuar por ai nuk ka paraqitur ndonjë dokument të tillë e as nuk ka ofruar ndonjë provë tjetër lidhur me pretendimet e tij ndaj palës përgjegjëse në ankesë.

3.14. Faktet e lartpërmendura dhe arsyetimi ligjor e ka shpirë gjykatën në përfundimin se Ismet Uka nuk ka dëshmi të mjaftueshme të deklaratës së tij. Prandaj, ankesa e tij është e pabazuar dhe konfirmohet vendimi i nxjerrë nga KKPK-ja.

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me nenin 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit.

Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Gjykatës Supreme.

Si pasojë, zbatohet regjimi normal i pagesës së taksave gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, taksat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit, (10.21, 10.15 dhe 10.1 të UA 2008/20) duke marrë parasysh se vlera e së drejtës së shfrytëzimit të pronës së kërkuar në mënyrës të arsyeshme mund të vlerësohet të jetë 10.000 € (neni 30 nën-paragrafi 2 i Ligjit për Taksat Gjyqësore): 100 € (50€+0.5% e 10.000 € deri në shumë maksimale prej 500 €).

Këto taksa gjyqësore në shumën prej 130 € duhet të merren përsipër I.U i cili e humbi rastin.

Sipas nenit 45.1 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, afati për pagesën e këtyre taksave është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë. Neni 47 paragrafi 3 parashih që në rast se pala nuk paguan taksën brenda afatit, pala do të duhet të paguaj një gjobë prej 50% të shumës së taksës. Nëse pala nuk e paguan taksën në afatin e dhënë, atëherë bëhet ekzekutimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Nënshkruar nga: Elka Filcheva-Ermenkova , Kryetare e Kolegjit, EULEX

Nënshkruar nga: Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Nënshkruar nga: Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Nënshkruar nga: Urs Nufer, Referent i EULEX-it